

**REGJISTRIMI, HYRJA, PËRDORIMI  
I DEGËS INTERNET**

## PËRMBAJTJA

1.	KUSHTET E PËRDORIMIT TË DEGËS INTERNET .....	4
2.	TIPET E VEPRIMEVE NË DEGËN INTERNET .....	4
3.	REGJISTRIMI .....	5
3.1	Regjistrimi për klientët që kanë një kartë aktive nga BKT .....	5
3.2	Regjistrimi me KOD UNIK/ për klientët që nuk kanë një kartë .....	7
3.2.1	Si mund të marr Kodin Unik? .....	7
4.	HYRJA NË DEGËN INTERNET .....	9
3.3	Hyrja në Degën Internet me Numrin e klientit ose numrin Personal .....	9
3.4	Hyrja në Degën Internet me Kartë.....	9
5.	PROCESI I MBYLLJES SË DEGËS INTERNET.....	10
6.	PROCESI I RIAKTIVIZIMIT TË PËRDORIMIT TË DEGËS INTERNET .....	10
7.	LLOGARITË .....	11
3.1	Llogaritë rrjedhëse .....	11
10.1.1.	Hapje llogarie rrjedhëse .....	11
10.1.2.	Llogaritë e mia rrjedhëse.....	12
3.2	Llogaritë e kursimeve.....	13
10.2.1.	Hapje llogari Kursimi .....	13
10.2.2.	Kursimet e mia .....	14
8.	DEPOZITAT .....	15
3.3	Depozitat e mia.....	15
3.4	Hapje e një depozite .....	16
3.5	Mbyllje depozite .....	17
9.	KARTAT E DEBITIT .....	17
3.6	Kartat e mia .....	17
3.7	Lidhja me llogaritë.....	17
3.8	Aplikimi për kartë debiti .....	17
10.	KARTAT E KREDITIT.....	18
3.9	Kartat e mia .....	18
3.10	Paguaj kartat e mia .....	19
3.11	Paradhënie .....	20
3.12	Ndarje me këste.....	20
3.13	Paguaj Kartë tjetër .....	21
3.14	Aplikim për Kartë .....	21
3.15	Limiti në Internet .....	22
11.	TRANSFERTAT .....	22
3.16	Mes llogarive të mia.....	22
3.17	Brenda BKT .....	23
3.18	Brenda Vendit.....	24
3.19	Ndërkombëtare .....	25
3.20	Transferta të Regjistruara.....	27
3.21	Historiku i Transfertave.....	27
12.	PAGESAT .....	27
3.22	Pay TV .....	27
3.23	Rimbushje Celulari.....	27
3.24	Gjobat e trafikut.....	28
3.25	Doganat.....	29
3.26	FATURAT .....	29
15.5.1	Pagesë fature .....	29
15.5.2	Autorizimet.....	30
15.5.3	Faturat me autorizime .....	31
15.5.4	Faturat e paguara.....	31
13.	KREDITË .....	32
3.27	Kreditë e mia .....	32
14.	INVESTIMET .....	32
3.28	Këmbimi valutor.....	32
3.29	Kursi këmbimit.....	33

3.30	Bonot e mia të thesarit .....	33
15.	PERSONALIZIME .....	33
3.31	Personalizime .....	33
18.1.1	<i>Ndryshim Fjalëkalimi</i> .....	34
18.1.2	<i>Limitet e veprimeve</i> .....	34
18.1.3	<i>Pulla Dixhitale</i> .....	34
18.1.4	<i>Kufizim Llogarie</i> .....	34
3.32	Informacione .....	34
18.2.1	<i>Deklarimi të Ardhurave</i> .....	34
18.2.2	<i>Njoftime të zgjuara</i> .....	34
18.2.3	<i>Informacion Kontakti</i> .....	36
18.2.4	<i>Informacion Personal</i> .....	36
16.	DALJE .....	37

## 1 KUSHTET E PËRDORIMIT TË DEGËS INTERNET

Ju mund të përdorni shërbimin e Degës Internet në BKT nëse:

1. Dini numrin e klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) ose numrin personal të kartës suaj të identitetit.
2. Keni firmosur KSHBI (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale, e cila firmoset në degë)
3. Keni një numër celular të vlefshëm të regjistruar në bankë.

## 2 TIPET E VEPRIMEVE NË DEGËN INTERNET

Më poshtë gjeni listën e transaksioneve që mund të kryhen në Degën Internet si dhe koston e shërbimit:

Transaksionet e "Degës Internet"	Çmimet <sup>1</sup>
Hapje llogarie rrjedhëse	Falas
Hapje llogarie kursimi	Falas
Verifikim i veprimeve të llogarisë	Falas
Pasqyrë e llogarisë	Falas
Hapje depozite	Falas
Monitorim i depozitave të klientit	Falas
Mbyllje depozite	Falas
Monitorim i kredive të klientit	Falas
Lidhja e llogarive me Kartën e Debitit	Falas
Ndarja e llogarive nga Karta e Debitit	Falas
Pagesë të Kartës së Kreditit	Falas
Ndryshimi i pagesës automatike të Kartës së Kreditit	Falas
Ndryshim i limitit për blerjet online me Kartë Krediti	Falas
Informacion mbi Kartën e Kreditit	Falas
Pagesë të një karte krediti tjetër të BKT	Falas
Paradhënie nga Karta e Kreditit	Sipas Kushteve të Punës në fuqi
Ndarje veprimi me këste	Falas / Sipas Kushteve të fushatës
Transferta brenda llogarive të mia	Falas
Transferta brenda BKT në Lekë	Falas
Transferta brenda BKT në monedhë të huaj	Sipas Kushteve të Punës në fuqi
Transferta brenda vendit	Sipas Kushteve të Punës në fuqi
Transferta Ndërkombëtare <sup>2</sup>	Sipas Kushteve të Punës në fuqi
Rimbushje celulari për operatorët në Shqipëri	Falas
Pagesë gjoba trafiku	Falas
Pagesë Dogane	Falas
Pagesë faturë utilitare	Falas
Autorizim i pagesës automatike të faturave	Falas
Monitorim i faturave të paguara	Falas
Monitorim i investimeve në bonot e thesarit	Falas
Blerje/shitje/këmbim valutash	Falas
Ndryshim fjalëkalimi	Falas
Vendosje limiteve për veprimet//llogaritë	Falas
Deklarata e të ardhurave	Falas
Konfigurim i njoftimeve BKT Smart	Falas
Përditësim i informacionit personal	Falas
Përditësim i informacionit të kontaktit	Falas

<sup>1</sup>Çmimet janë subjekt ndryshimesh dhe për referencë do të merren gjithmonë ato të publikuara tek kushtet e punës së bankës.

<sup>2</sup> Së shpejti klientët mund të kryejnë edhe transferata me BKT Kosovë


### 3 REGJISTRIMI

Për t'u regjistruar në Degën Internet, ndiqni hapat e mëposhtëm:

#### 3.1 Regjistrimi për klientët që kanë një kartë aktive nga BKT

Për klientët që kanë një kartë debiti ose krediti aktive të lëshuar nga BKT duhet të ndiqen hapat e mëposhtme për t'u regjistruar në Degën Internet:

1. Hapi i parë – referojuni figurës
2. Hapi i dytë – referojuni figurës



**1. Vendosni linkun e faqes zyrtare të BKT [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)**


**2. Klikoni "Individë"**

**3. Klikoni "Regjistrohu Tani"**

**\*Këtu mund të ndryshoni fjalëkalimin nëse nuk e mbani mend**

**\*Kujdes: Ky hap kryhet pasi ju të jeni regjistruar më parë në Degën Internet**

3. Hapi i tretë – referojuni figurës



**3. Klikoni "Regjistrohu Tani"**

**\*Këtu mund të ndryshoni fjalëkalimin nëse nuk e mbani mend**

**\*Kujdes: Ky hap kryhet pasi ju të jeni regjistruar më parë në Degën Internet**

4. Vendosni numrin e klientit (CIF) ose numrin personal të kartës suaj të identitetit, shkronjat që ju shfaqen në ekran (me shkronja KAPITALE dhe pa hapësira) dhe shtypni butonin VAZHDO. (Nr CIF është pjesë e nr. të llogarisë, i cili ju është dhënë në momentin e hapjes së llogarisë nga Dega)

5. Zgjidhni opsionin me kartë dhe plotësoni të dhënat e kartës suaj:
  - Zgjidhni tipin e kartës tuaj;
  - Vendosni 4 numrat e fundit të kartës që keni përzgjedhur;
  - Vendosni PIN e kartës që keni përzgjedhur.
6. Në faqen pasardhëse do të shfaqet numri juaj aktual i telefonit i cili do të jetë pjesërisht i koduar (psh:355 67\*\*\*\*123) dhe në numrin tuaj të telefonit do të dërgohet një SMS me kodin që do të vendoset në faqen e FNP (Fjalëkalim me një Përdorim). Vendosni kodin FNP dhe klikoni VAZHDO,
7. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:
  - Fjalëkalimi mund të përmbajë karaktere alfanumerike (shkronja/ numra)
  - Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere.
  - Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
  - Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (psh. 111111, 123456)

Në të njëjtën faqe ju do të shihni adresën e postës suaj elektronike që keni të regjistruar në BKT. Nëse dëshironi të ndryshoni adresën e postës suaj elektronike mund ta modifikoni atë dhe pasi të keni përfunduar shtypni butonin VAZHDO.

8. Zgjidhni pullën dixhitale, të cilën do ta shihni për sigurinë tuaj sa herë të logoheni në Degën Internet.
  - Zgjidhni një kategori nga lista.
  - Në varësi të kategorisë së zgjedhur, ju do të shihni një listë me Pulla dixhitale
  - Përzgjidhni sipas dëshirës njërën nga pullat, klikoni VAZHDO

Pasi të jeni regjistruar me sukses do të hyni në shërbimin e Degës Internet dhe faqja e parë e saj do të jetë si mëposhtë:



The screenshot shows the main dashboard of the BKT online banking system. It includes a sidebar menu on the left with options like 'Faqja Kryesore', 'Llogaritë', 'Depozitat', 'Kartak e Debitit', 'Kartak e Kreditit', 'Transferatat', 'Pagesat', 'Kredit', and 'Investimet'. The main area displays several key metrics: 'Asetet' (Assets) at 509,848 ALL, 'Gjendja e Disponueshme' (Available Balance) at 459,848 ALL, and 'Limiti Disponueshëm i Kartës' (Card Available Limit) at 35,625 ALL. There are also sections for 'Veprimet e Fundit' (Recent Transactions), a calendar for 'KOR 2019', and a 'Kursi i Këmbimit' (Exchange Rate) table. A 'Shërbimet e reja të BKT Smart' (New BKT Smart Services) banner is visible at the bottom right.

Callout boxes provide the following explanations:

- Këtu mund të zgjidhni menunë si menu të preferuar**: Points to the 'Menutë e Preferuara' star icon.
- Këtu do të shihni një info të përgjithshme mbi produktet që keni në BKT**: Points to the 'Asetet' section.
- Këtu do të shihni menunë e preferuara**: Points to the 'Menutë e Preferuara' dropdown menu.
- Këtu do të shihni listën e njoftimeve nga BKT Smart**: Points to the 'Shërbimet e reja të BKT Smart' banner.
- Këtu do të shihni info mbi menunë e përzgjedhur**: Points to the user profile dropdown menu.
- Këtu do të shihni menunë mbi infot personale; të kontaktini me BKT; ose të dilni nga Dega Internet**: Points to the 'Personalizime', 'Kontakti', and 'Dalje' options in the user profile menu.
- Menuja kryesore mbi shërbimet e ofruara në Degën Internet**: Points to the sidebar menu.
- Këtu do të shihni listen e transaksioneve të fundit në llogari**: Points to the 'Veprimet e Fundit' table.
- Këtu do të shihni veprimet sipas datave me ngjyrë me shpjegimet përkatëse në anë të kalendarit**: Points to the 'KOR 2019' calendar.
- Këtu do të shihni fushata të ndryshme të BKT**: Points to the 'Shërbimet e reja të BKT Smart' banner.
- Këtu mund të ndryshoni gjuhën**: Points to the 'Shqip' language dropdown menu.

### 3.2 Regjistrimi me KOD UNIK/ për klientët që nuk kanë një kartë


Regjistrimi me Kodin Unik do të përdoret vetëm në rastet kur klienti **nuk** është i pajisur me një kartë debiti/ krediti nga BKT dhe është aktiv vetëm nëpërmjet shërbimit të Degës Internet. Kodi Unik është një kod 4-shifror i cili dërgohet në numrin e telefonit celular të klientit të regjistruar në sistemin e BKT-se. Kodi unik ka jetëgjatësi përdorimi prej 24 orë nga gjenerimi i tij.

**Kujdes:** Regjistrimi me Kodin Unik ju mundëson çdo menu ku nuk kërkohen të dhënat e kartës të lëshuar nga BKT.

#### 3.2.1 Si mund të marr Kodin Unik?

Klienti paraqitet pranë Degës së BKT dhe firmos kërkesën për të aplikuar për "Regjistrim me anë të Kodit Unik", ose për të "Ndryshuar Fjalëkalimin". Pas nënshkrimit të kërkesës nga klienti pranë degës së BKT, dega i dërgon klientit në numrin e telefonit celular të regjistruar në sistemin e BKT Kodin Unik. Më pas, për t'u regjistruar në Degën Internet me anë të Kodit Unik, do të ndiqen hapat e mëposhtëm:

1. Shkoni në faqen zyrtare të BKT [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)
2. Klikoni Dega Internet/ Individë
3. Hapi i tretë – referojuni figurës



The screenshot shows the BKT login page with the following elements and annotations:

- Me Numër Klienti** / **Me Kartë** tabs.
- Input fields for **Numri Klientit / Numri Personal** and **Fjalëkalimi**.
- Checkboxes for **Përdor Tastierën Virtuale** and **S'kultoj Fjalëkalimin**.
- Vazhdo >** button.
- Regjistrohu tani** link.
- Norton** logo.
- AL** language selector.

Annotations:


- 3. Klikoni "Regjistrohu Tani"** (points to the "Regjistrohu tani" link).
- \*Këtu mund të ndryshoni fjalëkalimin nëse nuk e mbani mend** (points to the "S'kultoj Fjalëkalimin" checkbox).
- \*Kujdes: Ky hap kryhet pasi ju të jeni regjistruar më parë në Degën Internet** (points to the "S'kultoj Fjalëkalimin" checkbox).

Text below the form:

BKT nuk do t'ju dërgojë asnjë emailë ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik i gjerë (p.sh internet kafe).

Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 4 22 66 288 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj. Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më lart.

4. Vendosni numrin e klientit (CIF) ose numrin personal të kartës së identitetit shkronjat që ju shfaqen në ekran (me shkronja KAPITALE dhe pa hapësira) dhe shtypni butonin VAZHDO. **Numri CIF është pjesë e numrit të llogarisë, i cili ju është dhënë në momentin e hapjes së llogarisë nga Dega.**
5. Hapi i pestë – referojuni figurës



- Vendosni Kodin Unik (numrin 4-shifror) të dërguar më parë me SMS nga dega në numrin e telefonit që është regjistruar në BKT dhe klikoni VAZHDO

Pasi të kaloni me sukses hapat e mësipërme, në numrin tuaj të telefonit do të dërgohet një SMS me kodin që do të vendoset në faqen e FNP (Fjalëkalim me një Përdorim).

6. Vendosni kodin FNP dhe klikoni VAZHDO,

7. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:

- Fjalëkalimi mund të përmbajë karaktere alfanumerike.
- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere.
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV)
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (psh. 111111, 123456)

Në të njëjtën faqe ju do të shihni adresën e postës suaj elektronike që keni të regjistruar në BKT. Nëse dëshironi të ndryshoni adresën e postës suaj elektronike mund ta modifikoni atë dhe pasi të keni përfunduar shtypni butonin VAZHDO.

8. Zgjidhni pullën dixhitale, të cilën do ta shihni për sigurinë tuaj sa herë të logoheni në Degën Internet.

- Zgjidhni një kategori nga lista.
- Në varësi të kategorisë së zgjedhur, ju do të shihni një listë me Pulla dixhitale
- Zgjidhni sipas dëshirës një tërësi nga pullat, klikoni VAZHDO

Pasi të jeni regjistruar me sukses do të hyni në shërbimin e Degës Internet.



## 4 HYRJA NË DEGËN INTERNET


Pasi të kaloni me sukses hapat e regjistrimit ju mund të hyni në Degën Internet në 2 mënyra:

- 1- Npërmjet Numrin të klientit (CIF) ose Numrit Personal të kartës suaj të identitetit,
- 2- Ose nppërmjet të dhënave të kartës

### 4.1 Hyrja në Degën Internet me Numrin e klientit ose Numrin Personal

Klientët që duan të hyjnë në Degën Internet nppërmjet Numrit të Klientit ose Numrit Personal do të ndjekin hapat e mëposhtme:

1. Shkoni në faqen zyrtare të BKT [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)
2. Klikoni Dega Internet/ Individë
3. Hapi i tretë – referojuni figurës
4. Hapi i katërt – referojuni figurës
5. Hapi i pestë – referojuni figurës



The screenshot shows the BKT online banking login page. The browser address bar displays <https://new-ebank.bkt.com.al/ebanking/login.html>. The page title is "Hyrje". There are two tabs: "Me Numër Klienti" (selected) and "Me Kartë". The login form includes fields for "Numri Klientit / Numri Personal" and "Fjalëkalimi". There is a checkbox for "Përdor Tasterin Virtuale" and a "S'kujtet Fjalëkalimin" button. A "Vazhdo >" button is at the bottom. A Norton Security logo is also visible. Below the form, there is a "Regjistrohu tani" link and a disclaimer in Albanian. Three callouts are present: one on the left pointing to the "Me Numër Klienti" tab, one on the right pointing to the "S'kujtet Fjalëkalimin" button, and one on the left pointing to the "Fjalëkalimi" field.

**3.** Klikoni "Me numër Klienti";

**4.** Vendosi Numrin e Klientit ose Numrin Personal të kartës suaj të identitetit

**5.** Vendosi fjalëkalimin e krijuar gjatë regjistrimit dhe klikoni VAZHDO

\*Këtu mund të ndryshoni fjalëkalimin nëse nuk e mbani mend.

\*Kujdes: Ky hap kryhet pasi ju të jeni regjistruar më parë në Degën Internet

6. Konfirmoni Pullën dixhitale
7. Vendosi FNP e dërguar në numrin tuaj të celularit të regjistruar në sistemin e BKT dhe më pas do të hyni në Degën Internet

### 4.2 Hyrja në Degën Internet me Kartë

Klientët që duan të hyjnë në Degën Internet nppërmjet të dhënave të kartës së debitit/kreditit të lëshuar nga BKT, e cila duhet të jetë aktive, do të ndjekin hapat e mëposhtme:

1. Shkoni në faqen zyrtare të BKT [www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)
2. Klikoni Dega Internet/ Individë
3. Hapi i tretë – referojuni figurës
4. Hapi i katërt – referojuni figurës

**Hyrje**

Me Numër Klienti      **Me Kartë**

Numri Kartës \*

Kodi PIN      Ditëlindja

Përdor Tastierën Virtuale

Vazhdo >

Regjistrohu tani

BKT nuk do t'ju dërgojë asnjëherë emalle ku kërkohet të verifikoni/ndryshoni fjalëkalimet tuaja ose të ndryshoni ndonjë informacion tuajin personal. Ju lutem të mos kryeni asnjë veprim bankar në kompjutera në përdorim nga publik (gjere (p.sh internet kafe).

Në rast se nuk mbani mend Numrin e Klientit tuajin, ju mund ta mësoni atë nëpërmjet 4 22 66 288 Shërbimit të Klientit të BKT ose të gjithë degëve të saj. Për një informacion më të mirë të BKT E-Banking ne ju sugjerojmë ta përdorni atë nëpërmjet Mozilla Firefox ose Internet Explorer 7 dhe versionet më lart.

5. Konfirmoni Pullën dixhitale
6. Vendosni FNP e dërguar në numrin tuaj të celularit të regjistruar në sistemin e BKT dhe më pas do të hyni në Degën Internet

## 5 PROCESI I MBYLLJES SË DEGËS INTERNET

Në rast se nuk dëshironi të përdorni më Degën Internet duhet të kontaktoni me shërbimin e Klientit ose me degën tuaj, për të bllokuar përdorimin për këtë kanal.

## 6 PROCESI I RIAKTIVIZIMIT TË PËRDORIMIT TË DEGËS INTERNET

Në rast se është kryer më parë kërkesa për bllokim të përdorimit të Degës Internet dhe dëshironi ta përdorni përsëri këtë shërbim, duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm, për ta riaktivizuar:

1. Duhet të kontaktoni me shërbimin e Klientit ose me degën tuaj, për të riaktivizuar përdorimin për këtë kanal
2. Pas riaktivizimit të përdorimit të këtij kanali, duhet të hyni në shërbimin e Degës Internet, për të kaluar hapat e verifikimit

Për më shumë informacion dhe për çdo paqartësi që mund të keni, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni në numrin e telefonit të shërbimit të Klientit +35542266288, shërbim ky 24 orë në 7 ditë.

Pasi të jeni regjistruar në Degën Internet informacionet dhe transaksionet që mund të përfitoni nëpërmjet këtij shërbimi duke klikuar respektivisht në çdo menu janë të listuara sipas menuve të mëposhtme:

## 7 LLOGARITË

Nëse klikoni tek Menu **Llogaritë** do ju shfaqen 2 nënmenu:

1. Llogaritë rrjedhëse
2. Llogaritë e kursimeve


### 7.1 Llogaritë rrjedhëse

Këtu do të hapni një llogari të re rrjedhëse si dhe të shihni informacionin mbi llogaritë tuaja rrjedhëse ekzistuese në BKT.

#### 7.1.1 Hapje llogarie rrjedhëse

Klikoni këtë nënmenu për të hapur një llogari të re rrjedhëse në monedhat:

- Lek
- Dollar Amerikan
- Paund Britanik
- Dollar Australian
- Euro
- Dollar Kanadez
- Franga Zviceriane



Këtu ju jepet gjithashtu mundësia për të dërguar automatikisht në adresën e postës tuaj elektronike një pasqyrë të llogarisë suaj të re në periudhën e Zgjedhur duke:


- Zgjedhur Dërgo Pasqyrat e Llogarisë
- Frekuencën e Dërgimit
  - Tre mujore
  - Vjetore
  - Gjashtë mujore
  - Mujore
- Periudhën e fillimit
  - Zgjidhni muajin e fillimit të dërgesës (nëse keni Zgjedhur frekuencën Vjetore, Tre mujore ose Gjashtë mujore)
  - Zgjidhni datën e fillimit të dërgesës (nëse keni Zgjedhur frekuencën Mujore), klikoni VAZHDO

- Përzgjidhni llogarinë (nga e cila do të merret shuma që ju do të kaloni në llogarinë e kursimeve),
- Vendosni shumën që dëshironi të kaloni në llogarinë e kursimeve (minimumi është 1.500 Lek/ 15 EUR/ 15 USD/ 15 GBP),
- Vendosni një përshkrim sipas dëshirës, klikoni VAZHDO
- Përzgjidhni Nuk Pranoj (nëse nuk jeni dakort me kushtet e kontratës, lexoni me kujdes Kushtet)
- Përzgjidhni Unë Pranoj (nëse jeni dakort me kushtet e kontratës, lexoni me kujdes Kushtet) dhe më pas klikoni PËRFUNDO

Llogaria rrjedhëse është aktive që në momentin e hapjes.

### 7.1.2 Llogaritë e mia rrjedhëse

Këtu do të shihni listën e llogarive rrjedhëse aktive të hapura në BKT të cilat janë të autorizuar dhe informacionin si mëposhtë:



Numri Llogarisë	Emri Llogarisë	Gjendja	Gjendja Disp.
40	AT E A	64,525.18 ALL	124,525.18 ALL
40	9K E A...	0.00 ALL	0.00 ALL
40	L3 E A-LLOG KRE...	0.66 ALL	0.66 ALL
40	1M E A	0.00 GBP	0.00 GBP

- Listën e të gjitha llogarive rrjedhëse që ju keni në BKT,
- Numrin e llogarisë
- Emrin e llogarisë
- Gjendjen e llogarisë dhe monedhën e saj (në total, bashkë me shumën që mund të jenë të bllokuara për arsye të ndryshme)
- Gjendjen në Dispozicion (gjendje të cilën mund ta përdorni)
- Detajet e llogarisë si:
  - Kodin IBAN të llogarisë së Zgjedhur
  - Shuma të bllokuara (nëse ka)
  - Limiti i Paradhënies bankare (overdraft)
  - Degën në të cilën keni hapur llogarinë
  - Tipin e llogarisë
  - Datën e hapjes
  - Mbajtësin e llogarisë

Zgjidhni njërën nga llogaritë duke klikuar mbi të dhe duke klikuar tek:

- **Pasqyrat e llogarisë**, do të shihni detajet e pasqyrës së llogarisë së Zgjedhur (të cilat mund të dërgohen në adresën e postës suaj elektronike, të ruhen ose të printohen)
- **Veprimet e llogarisë** do të shihni të gjitha veprimet e llogarisë ndaj periudhës së Zgjedhur (të cilat mund të dërgohen në adresën e postës suaj elektronike, të ruhen ose të printohen, pasi t'i keni gjeneruar)

## 7.2 Llogaritë e kursimeve


Këtu do të hapni një llogari të re kursimi si dhe të shihni informacionin mbi llogaritë tuaja të kursimit ekzistuese në BKT.

### 7.2.1 Hapje llogari kursimi

Klikoni këtë nënmenu për të hapur një llogari të re kursimi në monedhat:

- Lek
- Euro
- Dollar Amerikan
- Paund Britanik

Vendosni një përshkrim sipas dëshirës.



Këtu ju jepet mundësia për të dërguar automatikisht në adresën e postës suaj elektronike një pasqyrë të llogarisë suaj të re në periudhën e Zgjedhur duke:

- Zgjedhur Dërgo Pasqyrat e Llogarisë
- Frekuencën e Dërgimit
  - Tre mujore
  - Vjetore
  - Gjashtë mujore
  - Mujore
- Periudhën e fillimit
  - Zgjidhni muajin e fillimit të dërgesës (nëse keni zgjedhur frekuencën Vjetore, Tre mujore ose Gjashtë mujore)
  - Zgjidhni datën e fillimit të dërgesës (nëse keni zgjedhur frekuencën Mujore), klikoni VAZHDO

Këtu gjeni info mbi llogarinë e kursimeve që po hapni

Zgjidhni nga lista llogarinë nga doni të merret shuma

Vendosni shumën që doni të kaloni në llogarinë e kursimit, minimumi 1500 Lek/ 15 EUR/ 15

Klikoni këtu për të pranuar kushtet e llogarisë

Mund të zgjidhni të përdorni limitin e overdraftit ose jo (nëse keni)

- Zgjidhni llogarinë (nga e cila do të merret shuma që ju do të kaloni në llogarinë e kursimeve),
- Vendosni shumën që doni të kaloni në llogarinë e kursimeve (minimumi është 1.500 Lek/ 15 EUR/ 15 USD/ 15 GBP),
- Zgjidhni nëse doni të përdorni limitin e overdraft (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Zgjidhni Pranoj (nëse jeni dakort me kushtet e kontratës, lexoni me kujdes Kushtet) dhe më pas klikoni VAZHDO
- Kotrolloni me kujdes faqen konfirmuese për detajet e llogarisë që do të hapni dhe nëse doni të vazhdoni me hapjen e saj, klikoni VAZHDO.

Llogaria e kursimit është aktive që në momentin e hapjes.

### 7.2.2 Kursimet e mia

Këtu do të shihni listën e llogarive të kursimeve të hapura në BKT të autorizuara dhe informacionin si mëposhtë:

Info mbi llogaritë e kursimit

Këtu mund të shkarkoni listën e llogarive sipas formatit

Këtu do të shihni pasqyrën e detajuar të llogarisë së kursimit

Këtu do të shihni listën e veprimeve të llogarisë së kursimit

Këtu do të shihni të dhënat mbi llogarinë e kursimit si kodin IBAN, etj.

- Listën e të gjitha llogarive të kursimit që ju keni në BKT,
- Numrin e llogarisë së kursimit
- Emrin e llogarisë së kursimit
- Gjendjen e llogarisë së kursimit dhe monedhën e saj (në total, bashkë me shumatat që mund të jenë të bllokuara për arsye të ndryshme)
- Gjendjen në Dispozicion (gjendje të cilën mund ta përdorni)
- Detajet e llogarisë së kursimit si:
  - Kodin IBAN të llogarisë së Zgjedhur
  - Shuma të bllokuara (nëse ka)
  - Degën në të cilën keni hapur llogarinë
  - Tipin e llogarisë
  - Datën e hapjes
  - Mbajtësin e llogarisë

Zgjidhni njëri nga llogaritë duke klikuar mbi të dhe duke klikuar tek:

- **Pasqyrat e llogarisë**, do të shihni detajet e pasqyrës së llogarisë së zgjedhur (të cilat mund të dërgohen në adresën e postës suaj elektronike, të ruhen ose të printohen)
- **Veprimet e llogarisë** do të shihni të gjitha veprimet e llogarisë ndaj periudhës së Zgjedhur (të cilat mund të dërgohen në adresën e postës suaj elektronike, të ruhen ose të printohen, pasi t'i keni gjeneruar)


## 8 DEPOZITAT

Nëse klikoni tek Menu **Depozitat** do ju shfaqen 3 nënmenu:

1. Depozitat e mia
2. Hapje Depozite
3. Mbyllje Depozite

### 8.1 Depozitat e mia

Këtu ju mund të shihni informacionin si mëposhtë:



Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menunë e preferuara

Këtu gjeni një përshkrim mbi menunë që keni zaidhur

Këtu mund të shkarkoni listën e llogarive sipas formatit

Këtu do të shihni të dhënat kontratën e depozitave

- Listën e depozitave aktive dhe të likujduara në BKT<sup>3</sup>
- Numrin e kontratës së depozitës
- Datën e fillimit të kontratës së Depozitës


<sup>3</sup> Depozitat e likujduara prej më shumë se 18 muaj nga data e likujdimit nuk do të shfaqen në Degën Internet

- Datën e maturitetit të kontratës së depozitës
- Shumën e Depozitës dhe monedhën
- Normën e Interesit
- Statusin e Depozitës
- Interesin e Depozitës
- Detajet e Depozitës
  - Tipi i rinovimit (nëse zgjidhni që depozita të rinvestohet automatikisht, e gjithë shuma principal + interes; vetëm principal; ose vetëm interesi)
  - Periudha e maturitetit
  - Dega e depozitës
  - Tipi i depozitës

## 8.2 Hapje e një depozite

Këtu ju mund të hapni një depozitë të re:

- Nëpërmjet listës së produkteve të BKT (me periudha fikse)
- Nëpërmjet Datës së maturitetit që ju doni (minimumi i periudhës së hapjes është 40 ditë)



Zgjidhni këtu një nga tipet e depozitës që i përshtatet nevojave tuaja

Këtu do të shihni hapat e veprimit

Zgjidhni monedhën e depozitës

Llogarisni interesin e depozitës së zgjedhur

Këtu do të klikoni para ose pas për të parë listën e plotë të tipeve të depozitave të ofruara nga BKT

- Më pas zgjidhni llogarinë nga e cila do të merret shuma e depozitës
- Zgjidhni nëse doni të përdoret limiti i overdraftit, ose jo (nëse keni një limit të aktivizuar)
- Zgjidhni tipin e rinovimit automatik
- Pranoni kushtet e depozitës (lexoni me kujdes kushtet dhe konditat)
- Në faqen konfirmuese mund të zgjidhni që të dërgoni kontratën e depozitës në postën tuaj elektronike dhe më pas klikoni VAZHDO për të përfunduar hapjen e depozitës.

Listën e normave të interesit dhe periudhave të hapjes së depozitave mund ta gjeni në linkun: <http://www.bkt.com.al/doc/buletini-shqip.pdf>



### 8.3 Mbyllje depozite<sup>4</sup>

Këtu do t'ju shfaqet lista e depozitave aktive që keni në BKT. Për të mbyllur një depozitë ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhni depozitën që doni të mbyllni
- Konfirmoni mbylljen e saj dhe klikoni butonin Mbyll Depozitën
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgoni mandatin e veprimit në postën tuaj elektronike, klikoni VAZHDO për të mbyllur depozitën

## 9 KARTAT E DEBITIT

Nëse klikoni tek Menu **Kartat e Debitit** do ju shfaqen 3 nënmenu:

1. Kartat e mia
2. Lidhja me llogaritë
3. Aplikim për kartë debiti

### 9.1 Kartat e mia

Këtu do të shihni informacion mbi:

- Tipin i Kartës
- Numrin e kartës (për arsye sigurie shfaqet pjesërisht i koduar)
- Mbajtësi (emër mbiemër)
- Gjendja e llogarisë (me të cilën është e lidhur karta e debitit)
- Gjendja në dispozicion e llogarisë (gjendja që mund të përdorni)

### 9.2 Lidhja me llogaritë

Këtu ju mund të lidhni ose të ndani kartën e debitit me deri në 3 llogari rrjedhëse të hapura në BKT, pavarësisht monedhës së llogarisë. Kjo mundëson shfaqjen ose jo të llogarive të lidhura me kartën e debitit në ATM e BKT.

Për të përdorur gjendjen e llogarive të lidhura me kartën e debitit mjafton zgjedhja e llogarisë gjatë vendosjes së kartës së debitit në një ATM të BKT.

**Ndarja** e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:

- Zgjedhur kartën e debitit (llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur)
- Zgjidhni nga lista e llogarive dytësore llogarinë që doni të ndani nga karta e debitit, klikoni NDAJE
- dhe më pas në faqen konfirmuese klikoni VAZHDO

**Lidhja** e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:

- Zgjedhur kartën e debitit (llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur)
- Zgjidhni nga lista e llogarive të palidhura, llogarinë që doni të lidhni me kartën e debitit, klikoni LIDHE,
- dhe më pas në faqen konfirmuese klikoni VAZHDO

### 9.3 Aplikimi për kartë debiti

Këtu mund të bëni aplikim për një kartë të re debiti, duke:

- Plotësuar Emrin e plotë mbi kartë
- Zgjidhni tipin e kartës që doni nga lista
- Vendosni numrin tuaj të telefonit ku doni të kontaktoheni
- Klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese klikoni VAZHDO për të dërguar kërkesën

---

<sup>4</sup> Depozitat e ofruara si garanci (kolateral), depozitat dyemrore dhe depozitat rekord nuk mund të mbyllën nga kanalet online

## 10 KARTAT E KREDITIT


Nëse klikoni tek Menu **Kartat e Kreditit** do ju shfaqen 7 nënmenu:

1. Kartat e mia
2. Pagesa e kartës
3. Paradhënie
4. Ndaje me këste
5. Pagesë kartë tjetër
6. Aplikim për kartë
7. Limiti në Internet

### 10.1 Kartat e mia

Këtu do të shihni informacionin mbi:

- Listën e kartave tuaja të kreditit të lëshuara nga BKT
- Tipin e kartës së kreditit (Master/Visa)
- Numrin e kartës (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
- Mbajtësin e kartës (emër mbiemër)
- Limitin e mbetur të kartës së kreditit (limiti në dispozicion për përdorim)
- Datën e prerjes së pasqyrës së llogarisë të fundit për kartën e kreditit
- Datën e fundit të pagesës për pasqyrën e fundit të llogarisë së kartës së kreditit
- Statusin e Kartës së kreditit
- Detajet e Kartës së kreditit, ku mund të shihni:
  - Tipi i kartës (kryesore apo dytësore)
  - Pikët e fituara (gjatë përdorimit të kartës në tregtarë të ndryshëm)
  - Limiti i Kartës (i aprovuar nga dega)



Zgjidhni që kjo menu të shfaqet direkt tek menutë e preferuara

Këtu gjeni një përshkrim mbi këtë menu

Këtu mund të shkarkoni listën e kartave sipas formatit

Info mbi kartat

Këtu do të shihni info të detajuar të kartës

Këtu do të shihni të gjitha transaksionet e shfaqura në nxjerrjet e llogarive të kartës së kreditit

Këtu do të shihni të gjitha transaksionet që do t'ju shfaqen në nxjerrjen e pasqyrës së ardhshme të kartës së kreditit

Tipi Kartës	Numri i Kartës	Mbajtësi	Limiti Mbetur	Data Prerjes	Data Fundit	Statusi
MasterCard	5437 XXXX XXXX XXXX	EL A	81,959.74 ALL	22.01.2019	01.02.2019	Aktive


Në këtë nënmenu ju shfaqen dhe 2 opsione për të marrë informacion më të detajuar:

- **Pasqyrat**, këtu mund të shihni çdo informacion mbi nxjerrjet e pasqyrave të kartës së kreditit (detyrimi mujor i kartës së kreditit). Nëse klikoni në njërin nga pasqyrat do t'ju shfaqet lista e transaksioneve për atë periudhë.

- **Transaksionet e fondit**, këtu do t'ju shfaqet lista e transaksioneve të cilat do të shfaqen në nxjerrjen e pasqyrës së kartës së kreditit të ardhshme me detajet e mëposhtme:
  - o Data e veprimit (data kur është kryer transaksioni)
  - o Përshkrimi i veprimit (vendi ku është kryer transaksioni)
  - o Shuma (shuma e transaksionit)
  - o Tipi (statusi i transaksionit e autorizuar nëse është i përfunduar, ose në proces nëse transaksioni pritet të tërhiqet nga tregtari)

## 10.2 Paguaj kartat e mia

Këtu ju mund të kryeni pagesën e detyrimit të kartës suaj të kreditit:



The screenshot shows the 'Pagesë e Kartës' (Card Statement) screen in the BKT mobile app. It displays card details, payment options, and account balances. Callouts provide instructions on how to use these features:

- Zgjidhni nga lista kartën për të cilën doni të kryeni pagesën**: Points to the dropdown menu for selecting a card.
- Vendosni shumën manualisht nëse doni të kryeni një pagesë ndryshe nga detyrimi i kartës**: Points to the manual payment amount input field.
- Zgjidhni nga lista e llogarive nga e cila doni të kryeni**: Points to the dropdown menu for selecting an account.
- Klikoni këtu për të krijuar një pagesë automatike të detyrimit të kartës**: Points to the 'Ndrysho Pagesën Automatikë' button.
- Klikoni këtu për të kryer vetë manualisht një pagesë të detyrimit të kartës**: Points to the 'Paguaj' button.
- Klikoni këtu që të shfaqet detyrimi i mbetur i kartës**: Points to the 'Shuma e Ngjellur' (Total Due) field.
- Klikoni këtu që të shfaqet detyrimi minimal i kartës**: Points to the 'Shuma Minimale e Ngjellur' (Minimum Due) field.

1- **Pagesa e kartës**, ju mund të bëni pagesën e detyrimit të kartës manualisht duke zgjedhur:

- shumën totale të detyrimit (nëse klikoni këtu, automatikisht do të shfaqet shuma e mbetur e detyrimit të kartës së zgjedhur)
- shumën minimale (nëse klikoni këtu, automatikisht do të shfaqet shuma minimale e detyrimit të kartës së zgjedhur)
- ose një shumë tjetër (ku duhet të vendosni sipas dëshirës manualisht shumën e pagesës)

Nëse doni të kryeni pagesë manuale ndiqni hapat e mëposhtme:

- Zgjidhni nga lista e kartave të kreditit, kartën për të cilën do të kryhet pagesa, Klikoni **PAGESË MANUALE**
- Zgjidhni llogarinë nga e cila doni të merret pagesa e kartës
- Zgjidhni **Shuma minimale e ngjellur** (nëse doni të kryeni minimumin e detyrimit)
- Zgjidhni **Shuma e ngjellur** (nëse doni të kryeni detyrimin total të kartës së kreditit)
- Shënoni direkt një **Shumë** në kutinë përkatëse (nëse doni të kryeni një shumë të ndryshme nga minimumi ose totali i detyrimeve të kartës së kreditit)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdoret limiti i overdraft (nëse ka) për të kryer këtë pagesë, dhe më pas klikoni **PAGUAJ** dhe në faqen konfirmuese mund të zgjidhni

- nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike
- klikoni VAZHDO për të kryer pagesën

**Pagesa e kartës së kreditit e kryer nëpërmjet Degës Internet aktivizohet në moment.**

- 2- **Pagesë automatike**, ju mund të Zgjidhni që automatikisht nga llogaria juaj të mbahet:
- shuma minimale, ose
  - shuma totale e kartës suaj të kreditit

Nëse doni të kryeni pagesë automatike ndiqni hapat e mëposhtem:

- Zgjidhni nga lista e kartave të kreditit, kartën për të cilën do të kryhet pagesa, Klikoni NDRYSHO PAGESËN AUTOMATIKE
- Zgjidhni **Shuma Minimale** (nëse doni që të autorizoni bankën që të kryej automatikisht në datën e fundit të pagesës, shumën minimale të detyrimit të kartës suaj të kreditit), ose
- Zgjidhni **Shuma Totale** (nëse doni që të autorizoni bankën që të kryej automatikisht në datën e fundit të pagesës, shumën totale të detyrimit të kartës suaj të kreditit), më pas klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese VAZHDO për të aktivizuar këtë kërkesë

### **10.3 Paradhënie**

Këtu ju mund të transferoni limitin e \*paradhënies nga karta juaj e kreditit në llogarinë tuaj rrjedhëse duke:

- Zgjedhur nga lista e kartave të kreditit, kartën nga e cila do të kryhet paradhënia,
- Zgjidhni llogarinë në të cilën do të kalohet paradhënia
- Klikoni **Limiti Maksimal i Paradhënies** (nëse doni të kaloni këtë limit në llogarinë e Zgjedhur)
- Klikoni **Limiti Mbetur** (nëse doni të kaloni këtë limit në llogarinë e Zgjedhur)
- Vendosni manualisht një **Shumë tjetër** (nëse doni të kryeni një shumë më të ulët se limiti i paradhënies),
- Klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese mund të zgjidhni nëse të dhënat e këtij veprimi t'i merrni me email në adresën tuaj të postës elektronike, klikoni VAZHDO për të kryer veprimin

**\*Limiti i paradhënies nga karta e kreditit është 10% e limitit total të kartës së kreditit të aprovuar nga dega, i cili mund të përdoret për tërheqje në ATM, etj.**

**Kalimi i tërheqjes nga karta në llogarinë e Zgjedhur aktivizohet në moment.**

### **10.4 Ndarje me këste**



Këtu ju mund të ndani me këste një transaksion të kryer në një POS jo të BKT ose një transaksion të kryer në internet. Këtu do ju shfaqet lista e ofertave bashkë me transaksionet që përmbushin kushtet e ofertave të ndryshme. Nëse doni të ndani një transaksion me këste ndiqni hapat e mëposhtme:

